



# USHTRIA



Viti i 72-të i botimit Nr. 21 (827618)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 31 Maj 2019

## TAKIMI I 181-TË I KOMITETIT USHTARAK TË NATO-S



### Gjeneral brigade Kollçaku me Shefat e ushtrive të NATO-s në Bruksel

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku mori pjesë më 22 maj, në Takimin e 181-të të Komitetit Ushtarak në nivel Shefash Shtabi të Përgjithshëm të vendeve të NATO dhe ato partnere, në Bruksel, Belgjikë. 29 shefat e Mbrojtjes, ku e ftuar ishte dhe Maqedonia e Veriut, u mblodhën së bashku për të diskutuar mbi Strategjinë e re ushtarake të NATO-s, zonën

e përgjegjësisë së Komandantit Suprem të Forcave Aleate të Evropës (SACEUR) dhe qëndrimin për sa i përket përfaqësjes “pengesë dhe mbrojtje” të Aleancës. Shefat e Mbrojtjes filluan ditën e tyre duke u takuar me sekretarin e Përgjithshëm të NATO Jens Stoltenberg, ku diskutimet u përqendruan në çështjet kyçe strategjike me të cilat përballen Aleanca. Më tej... >>> faqe 2

**MARIO TRUPJA**  
**Një oficer shqiptar diplomohet në Akademinë e Marinës Amerikane**



>>> faqe 7

## Mbërrijnë ekspertët e ushtarakëve amerikanë Helikopterët e rinj “Black Hawk”, fillon trajnimi për pilotët tanë

Helikopterët “Black Hawk” do të futen në përdorim të Forcës sonë Ajrore pas finalizimit të marrëveshjes nga ministrja Olta Xhaçka, gjatë vizitës së saj në Shtetet e Bashkuara në muajin prill >>> faqe 3



## Shqipëri-Greqi:

### Nënshkruhet Programi i Bashkëpunimit Ushtarak për vitin 2019

Shqipëria dhe Greqia nënshkruan më 22 maj në Athinë, Programin e Bashkëpunimit Ushtarak për vitin 2019, pikat kryesore të së cilit janë bashkëpunimi në operacionet e kërkim-shpëtimit dhe policimin e hapësirës sonë ajrore. Programi i Bashkëpunimit Ushtarak përfshin trajnimin...



>>> faqe 2

## “Vizioni i CIMIC 2015”

### Bashkëpunimi civilo-ushtarak në funksion të NATO-s

Konferenca e Drejtuesve Kryesore të Civil-Military Cooperation (CIMIC) të NATO, këtë vit u mbajt në Shqipëri nga data 27-30 maj, në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes. Qëllim i saj është të analizojë se si CIMIC mbështet strategjinë e NATO për të luftuar kërcënimet që shfaqen vazhdimisht. Gjatë fjalës së tij zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi tha se Shqipëria si anëtare e NATO e vlerëson bashkëpunimin civilo - ushtarak si një nga faktorët kryesorë të konceptit të Mbrojtjes dhe parandalimit... >>> faqe 3



Jens Stoltenberg pret Kryeministrin e Estonisë, Juri Ratas

## Estonia, aleat i afërt dhe shumë i vlefshëm i NATO-s

>>> faqe 8

### VIZITA/ HADËRGJONAJ-BEGAJ

## Konsolidim i bashkëpunimit midis FARSH dhe FSK-së

faqe 5

### SIPAS STANDARDEVE TË NATO-S DHE IAMSAR

## U zhvillua stërvitja e koduar “Durrës-SAREX 2019”

faqe 6

Takimi i 181-të i Komitetit Ushtarak të NATO-s

# Gjeneral brigade Kollçaku me Shefat e ushtrive të NATO-s në Bruksel

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku mori pjesë në Takimin e 181-të të Komitetit Ushtarak në nivel Shefash Shtabi të Përgjithshëm të vendeve të NATO dhe ato partnere, në Bruksel, Belgjikë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku mori pjesë më 22 maj, në Takimin e 181-të të Komitetit Ushtarak në nivel Shefash Shtabi të Përgjithshëm të vendeve të NATO dhe ato partnere, në Bruksel, Belgjikë. 29 shefat e Mbrojtjes, ku e ftuar ishte dhe Maqedonia e Veriut, u mbledhën së bashku për të diskutuar mbi Strategjinë e re ushtarake të NATO-s, zonën e përgjegjësisë së Komandantit Suprem të Forcave Aleate të Evropës (SACEUR) dhe qëndrimin për sa i përket përjasjes “pengesë dhe mbrojtje” të Aleancës.

Shefat e Mbrojtjes filluan ditën e tyre duke u takuar me sekretarin e Përgjithshëm të NATO Jens Stoltenberg, ku diskutimet u përqendruan në çështjet kyçe strategjike me të cilat përballet Aleanca. Më tej, takimi ka vijuar me nënshkrimin e Strategjisë së re Ushtarake nga shefat e Mbrojtjes të forcave aleate. Nënshkrimi i saj shënon një hap të rëndësishëm në përshtatjen e Aleancës për sfidat gjithnjë e më komplekse të sigurisë me të cilat NATO përballet. Nga ana e tij, sir Stuart Peach deklaroi në këtë takim se: “Strategjia do të udhëheqë vendim-marrjen ushtarake të Aleancës dhe do t’i sigurojë autoritetet ushtarake të NATO një referencë përfundimtare të politikave, duke na mundësuar që të realizojmë misionin tonë kryesor, duke mbrojtur pothuajse 1 miliard njerëz”.

Në sesionin mbi zonën e përgjegjë-



sisë së SACEUR, Komiteti Ushtarak ftoi kryetarin e Komitetit Ushtarak të Bashkimit Evropian, gjeneral Graziano, për t’u bashkuar me ta. Shefat e Mbrojtjes theksuan përpjekjet e BE për zhvillimet në fushën e Mbrojtjes

dhe punën e NATO për të mundësuar, që fusha e përgjegjësisë së SACEUR të përforcohen reciprokisht.

Gjatë takimit, shefat e Mbrojtjes morën një informacion të detajuar mbi situatën aktuale të sigurisë në dhe rreth

Ukrainës dhe sfidat e vazhdueshme që burojnë nga rajoni i Detit të Zi. Duke folur me partnerët e Dialogut Mesdhetar, diskutimet u përqendruan në ndërtimin e kapaciteteve në rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikën e

Veriut, rritjen e ndërveprueshmërisë dhe shënimin e njëzet e pesë viteve të dialogut. Më herët shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku mori pjesë gjithashtu në takimin e Shefave të Shtabit të vendeve anëtare dhe partnere të BE (EUMC plus partners at CHOD level), në Bruksel, Belgjikë. Në fjalën e tij të hapjes, kryetari i Komitetit Ushtarak të Bashkimit Evropian, gjeneral Graziano, falënderoi vendet partnere për kontributin e tyre përkrah vendeve të BE në misionet e drejtuara prej saj.

Kryetari i Komitetit Ushtarak të Bashkimit Evropian, gjeneral Graziano, në fjalën e tij, përveç informimit për misionet trajnuese të BE, falënderoi vendet jo anëtare të BE për kontributin shumë të vlefshëm dhe domethënës përkrah vendeve të BE në misionet e drejtuara prej saj. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbështesin misionin trajnues të Bashkimit Evropian në Mali me trupa EOD që nga nëntori i vitit 2016 dhe në vazhdim.

SHQIPËRI-GREQI:

## Nënshkruhet Programi i Bashkëpunimit Ushtarak për vitin 2019

Shqipëria dhe Greqia nënshkruan më 22 maj në Athinë, Programin e Bashkëpunimit Ushtarak për vitin 2019, pikat kryesore të së cilit janë bashkëpunimi në operacionet e kërkim-shpëtimit dhe policimin e hapësirës sonë ajrore. Programi i Bashkëpunimit Ushtarak përfshin trajnimin në Qendrën e Trajnimit Operacional të Ndërrhyrjes Detare të NATO-s dhe Qendrën e Trajnimit Shumëkombësh të Mbështetjes së Paqes, pjesëmarrjen në stërvitje të përbashkëta, shkëmbime e trajnuesish dhe vizita të delegacioneve respektive ushtarake.

Programi i Bashkëpunimit Ushtarak për vitin 2019 u nënshkrua në Athinë nga drejtori i Marrëdhënies Ndërkombëtare në Shtabin e Përgjithshëm të



FA greke, Michael Naoum dhe drejtori i Politikave të Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes së Shqipërisë, Florian Kali. Gjatë takimit u shqyrtuan fusha të tjera me interes të përbashkët si pjesë

e forcimit të bashkëpunimit ekzistues në fushën e mbrojtjes, ndërkohë që më 1 korrik 2019, Shqipëria do të marrë Presidencën e Ministerialit të Mbrojtjes për Europën Juglindore (SEDM).

### Misioni Trajnues i Bashkimit Evropian



### Ekipi i tetë i EOD nis për misionin EUTM Mali-Afrikë

Grupi i tetë i specialistëve të Kompanisë EOD (Explosive Ordnance Disposal) të batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse, është nisur për kryerjen e misionit të tij, në Mali, Afrikë. Ky grup trajnuesish është pjesë e EUTM Mali, Afrikë (Misioni Trajnues i Bashkimit Evropian), i cili përfaqëson Shqipërinë në këtë mision, të cilët do të shërbejnë për gjatë një periudhe 6 mujore. Misioni i tij është sigurimi dhe mbështetja e plotë për asgjësimin e municioneve eksplozive për Forcat e Armatosura të Malit, për të mbajtur nivelin e duhur të sigurisë në KTC (Kampi i Trajnimit Koulikoro), duke përfshirë dhe reagimin nga rreziqet që vijnë nga municionet e paplasura dhe mbetjet eksplozive të luftës. Gjithashtu një tjetër detyrë e grupit të tetë të specialistëve të EOD në këtë mision, është zhvillimi i trajnimeve C-IED (Countering Improvised Explosive Devices) me njësitë luftarake të Malit. Ky grup përbëhet nga katër specialistë EOD nga batalioni i Xhenios, të mire trajnuar dhe drejtohet nga Toger Ledion Mino, me detyrë zv/komandant i togës EOD. Specialistët e Kompanisë EOD, u përcollën nga komandanti i batalionit të Xhenios, N/Kolonel Hajdar Gurra, i cili i uroi atyre rrugë të mbarë dhe suksese në përmbyshjen e detyrës së ngarkuar.

STAFI

**DED KOLA**  
Shef i Sektorit të  
Botimeve & Kryeredaktor

**Gazetarë:**  
Mimoza **GOLIKJA**

**Gazetarë:**  
Saimir **ALIJA**

**Graphic Designer:**  
Afërdita **HYSAJ**  
**Redaktore/Korrektore:**  
Anila **DODA**

**ADRESA:**  
Rruga e Dibrës/  
Garnizoni “Skënderbej”

# Mbërrijnë ekspertët e ushtarakëve amerikanë

**S**ë shpejti helikopterët “Black Hawk” do të jenë pjesë e Forcës sonë Ajrore. Teknikët e Forcës Ajrore kanë filluar të trajnohen nga kolegët e tyre amerikanë për helikopterët e rinj “Black Hawk”, që pritet të hyjnë në përdorim të Forcave tona të Armatosura. Teknikët shqiptarë u njohën me njohuritë bazë të procedurave të fluturimit, të cilat janë të ndryshme nga ato me të cilat ata punojnë përditë.

Kreu i ekipit të ushtarakëve amerikanë, të cilët nisën trajnimin e teknikëve tanë, shpjegoi natyrën e këtij trajnim si dhe vlerësoi aftësitë e teknikëve të Forcës sonë Ajrore. “Ata po mësojnë aftësitë themelore për t’u përgatitur për një strukturë të re fluturimi, e cila do të vijë shumë shpejt. Ata kanë punuar me shumë struktura helikopteri, çka tregon që kanë aftësi vërtet të mira dhe na ndihmon t’i përdorim të gjitha këto aftësi për kornizën e re ajrore.

Pas koncepteve bazë do të nisë trajnimi edhe në praktikë. Ende ka nevojë për trajnim specializues, si për kornizën e re ajrore, ashtu edhe për pjesën elektrike, karakteristikat e motorit. “Black Hawk” ka një motor T700, i ndryshëm nga helikopterët që keni tani. Nuk ka asgjë përtej aftësive të tyre që mund të mos e bëjnë, thjesht ka karakteristika të ndryshme nga korniza aktuale ajrore.”, - u shpreh nënkolonel Lance Allred nga Forca Ajrore e SHBA në Evropë.

Në përfundim të fazës së parë të trajnimit, ekipi amerikan pajisi me certifikata teknikët e Forcës Ajrore shqiptare, të cilët do të vijnë trajnimin për helikopterët e rinj në faza të tjera.

# Helikopterët e rinj “Black Hawk”, fillon trajnimi për pilotët tanë

*Helikopterët “Black Hawk” do të futen në përdorim të Forcës sonë Ajrore pas finalizimit të marrëveshjes nga ministrja Olta Xhaçka, gjatë vizitës së saj në Shtetet e Bashkuara në muajin prill*



Bashkë me teknikët do të nisë edhe trajnimi i pilotëve në Gardën Kombëtare të New Jersey-t, përpara se të jenë plotësisht operacionalë sa i përket operacio-

neve të kërkim-shpëtimit, stërvitjeve, transportit, por edhe mirëmbajtjes së tyre. Helikopterët “Black Hawk” do të futen në përdorim të Forcës sonë

Ajrore pas finalizimit të marrëveshjes nga ministrja Olta Xhaçka, gjatë vizitës së saj në Shtetet e Bashkuara në muajin prill.



**GJENERALMAJOR PEDERSEN**  
**Vlerësim për kontributin e Shqipërisë për sigurinë në Rajon**

Zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi priti në zyrën e tij, më 27 maj, gjeneralmajor Pedersen, DCOS, Partnership Directorate në SHAPE (Supreme Headquarters Allied Powers Europe), i cili ndodhej në Shqipëri në kuadër të Konferencës tre ditore, të Drejtuesve Kryesore të CIMIC.

Gjatë këtij takimi gjeneralmajor Pedersen shprehu vlerësimin për rolin që po luan Shqipëria në sigurinë dhe paqen në rajon si dhe për angazhimin e Forcave të Armatosura Shqiptare në misionet e NATO. Gjeneralmajor Pedersen shprehu dhe ngushëllimet për ngjarjen e rëndë të ndodhur pak javë më parë në Letoni, ku dy ushtarakë shqiptarë, të cilët ndodheshin atje me mision, humbën jetën në krye të detyrës.

Nga ana tjetër zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi, gjatë këtij takimi, vuri theksin edhe tek ngjarjet në Ballkan që lidhen me shtetet fqinje si Maqedonia e Veriut dhe Kosova. “Procesi i anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në Aleancë është një lajm shumë i mirë për të gjithë rajonin, për politikën e bashkëpunimit dhe për sigurinë në rajon”, - tha Koçi. Po ashtu, Koçi shtoi se, tashmë shpreson që procesi i transformit të Forcave të Armatosura të Kosovës të mbërrijë në standartet e NATO në mënyrë që dhe Kosova të bëhet pjesë e komunitetit tonë euroatlantik.

## “VIZIONI I CIMIC 2015”

# Bashkëpunimi civilo-ushtarak në funksion të NATO-s

*Konferenca tre ditore e Drejtuesve Kryesore të Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak të NATO-s: “Vizioni i CIMIC 2015”*

**K**onferenca e Drejtuesve Kryesore të Civil-Military Cooperation (CIMIC) të NATO, këtë vit u mbajt në Shqipëri nga data 27-30 maj, në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes. Qëllim i saj është të analizojë se si CIMIC mbështet strategjinë e NATO për të luftuar kërcënimet që shfaqen vazhdimisht.

Gjatë fjalës së tij zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi tha se Shqipëria si anëtare e NATO e vlerëson bashkëpunimin civilo - ushtarak si një nga faktorët kryesorë të konceptit të Mbrojtjes dhe parandalimit të konflikteve të ardhshme të NATO: “Për këtë arsye qeveria shqiptare ka rritur ndjeshëm mbështetjen ligjore, udhëzimet, masat dhe bashkëpunimin midis qeverisë qendrore, pushtetit vendor, aktorëve civilë dhe Forcave të Armatosura për të përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë me qëllim formësimin e një vizioni të qartë të bashkëpunimit civilo - ushtarak. Një rëndësi të veçantë qeveria shqiptare ka treguar me pjesëmarrjen e saj në nisimat rajonale dhe bashkëpunimit në përballimin e sfidave, si lufta kundër terrorizmit, emigracionit të paligjshëm, emergjencave civile etj. Forcat e Armatosura shqiptare kanë luajtur një rol të rëndësishëm në konsolidimin e filozofisë së bashkëpunimit civilo-ushtarak në vend duke transmetuar tek aktorët e tjerë modelin dhe shembullin e pjesëmarrjes së suksesshme në parandalimin dhe zgjidhjen e emergjencave, jo



vetem brenda vendit, por dhe jashtë saj. Sot, një kontingjent i Forcës Detare shqiptare vepron me sukses në detin Egje në kuadrin e operacionit të përbashkët të NATO-s në parandalimin e fluksit të migrantëve. Vetëm vitin e kaluar FA morën pjesë në operacione të zjarreve, përmbytjeve, ngritje të urave, hapje të rrugëve të reja etj”, - tha Koçi.

Në konferencë mbajtën fjalën e tyre edhe Gjen-

eral brigade Tonin Marku, në pozicionin e drejtorit të CIMIC në SHAPE si dhe gjeneralmajor Odd Egil Pedersen, DCOS, Partnership Directorate, SHAPE, i cili referoi mbi Strategjinë Ushtarake të NATO. Gjatë punimeve të kësaj konference u referuan dhe diskutime të tjera në lidhje me projektimin e stabilitetit dhe luftës kundër terrorizmit në rajone jo të qëndrueshme, si dhe u trajtuan çështje rreth kërcënimeve hibride, ruajtjes së qëndrueshmërisë nëpërmjet mbështetjes civile në rastet e katastrofave natyrore dhe modernizimit të CIMIC. Gjeneralmajor Pederson, u prit në një takim të veçantë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i cili në emër të SACEUR shprehu mirënjohje për angazhimin e Shqipërisë në misionet e NATO, e cila proporcionalisht është në krye të shteteve kontribuese në operacionet e NATO. Nga ana e tij gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku e siguroi atë se Shqipëria është e vendosur të vijojë kontributin e saj në operacionet e NATO si dhe do vijojë të jetë për politikën e dyerve të hapura për vendet që aspirojnë për tu integruar në NATO.

Konferenca e Drejtuesve Kryesore të CIMIC të NATO 2019, ku merrnin pjesë rreth 100 përfaqësues nga komuniteti kombëtar i Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak dhe Marrëdhëniet me Publikun ka nisur më datë 27 maj dhe ka zgjatur tre ditë.

## GARNIZONI I FORCËS TOKËSORE

## Përfundon Kursi 5 javor Fillestar i Nënoficerit

*Certifikohen kursantët e Kursit të 62-të Fillestar të Nënoficerit në ANO*

Në ambientet e Garnizonit të Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Fillestar të Nënoficerit. Kursi Fillestar i Nënoficerit u zhvillua në ANO për një periudhë 5-javore me 190 orë mësimore. Kursi ishte i fokusuar në lëndët Leadership, Rregullore-Ligjshëmëri, Taktikë, SHLT, Përgatitje Zjarri, Përgatitje Fizike, Testime. Objektivi i programit mësimor ishte hedhja e bazave për karrierën e Nënoficerit, ofrimi i njohurive teoriko-praktike për drejtimin e grupit dhe niveleve të njësuarave me të si dhe shkëputjen nga përgjegjësia individuale në aftësi e përgjegjësi si drejtues dhe lider. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm, zv.Komandanti i ANO N/Kolonel Bedri Qoli, dhe të ftuar të tjerë.

Fjalën përshëndetëse e mbajti zv.komandanti i ANO-së, ku ndwr tw tjerash wshtw shprehur se: “Është shumë e rëndësishme

për ju përfundimi i këtij kursi, ku ju morët elementët fillestar më të rëndësishëm të të qënit një nënoficer i ardhshëm. Ndaj këto njohuri që ju i keni marrë mbi konceptet e liderit të së ardhmes të një ushtrie tashmë me standarte, ju duhet ti shfrytëzoni më së miri në karrierën tuaj ushtarake. Gjithashtu do të kërkoja nga ju që njohuritë e marra në ANO ti përditësoni akoma dhe më shumë nëpërmjet literaturës ushtarake, dhe jo vetëm, nëpërmjet informacioneve të ndryshme zyrtare në internet e kudo tjetër për tu rritur e zhvilluar më tej si ushtarakë, por në rradhë të parë si qytetarë të këtij vendi. “ Në emër të të gjithë kursantëve, përshëndeti ushtar IV Bilbil Biba. Ai falenderoi të gjithë trupën mësimdhënëse të ANO-së, që me shumë profesionalizëm, këmbëngulje dhe durim mësuar, stërvitën dhe bënë që kursantët të ndjehen më të sigurt në detyrat që do tju besohen në të ardhmen.



## Në Batalionin e Parë të Këmbësorisë të Forcës Tokësore

## Dita e hapur në Batalionin e Parë të Këmbësorisë

*Zv/Ministri Petro Koçi: “Në Qarkun e Shkodrës, por edhe në Qarkun e Lezhës, kemi plot djem dhe vajza, që janë të gatshëm të jenë pjesë e Forcave të Armatosura”*

Në Batalionin e Parë të Këmbësorisë të Forcës Tokësore (b1kFT), u zhvillua më 23 maj, Dita e Hapur me pjesëmarrjen e gjimnazistëve të shkollave të mesme, në zonën e Vaut të Dejës ku ndodhet i dislokuar edhe b1kFT. Aktiviteti u zhvillua në bashkëpunim me Qendrën e Rekrutim Personelit (QPR), në kuadër të programit “Rini-Mundësi-Talent-Dinjitet”, i cili ka si synim të informojë opinionin publik dhe kryesisht të rinjtë në lidhje me punën e përditshme të Forcave të Armatosura dhe me mundësinë e punësimit, që ato ofrojnë për një karrierë dinjitoze në shërbim të atdheut.

Dita e Hapur, filloi me demonstrimet stërvitore në tre stacione respektivisht: stacioni luftimit trup me trup; reagimi në rastet e emergjencave civile si dhe reagimi në rastet e sulmeve komplekse terroriste. Në të trija këto stacione, trupat e Batalionit të Parë të Këmbësorisë treguan përgatitjen e tyre të lartë nëpërmjet veprimeve të sakta dhe tepër profesionale duke merituar vëmendjen dhe kureshtjen e të gjithë pjesëmarrësve dhe sidomos të rinjve nga gjimnazet.

I pranishëm në këtë eveniment, ishte edhe zëvendësministri i Mbrojtjes z.Petro Koçi, i cili duke marrë fjalën për të përshëndetur pjesëmarrësit, ndër të tjera u shpreh: “...ne duam që në Forcat e Armatosura të kemi djem dhe vajza, që janë të zotë, që janë të aftë, që përballojnë testimet intelektuale, psikologjike dhe fizike, por ajo që është kryesorja është, që ata të jenë patriotë të vërtetë, sepse t'i shërbesh Forcës së Armatosur do të thotë që, kur rekrutohesh, të bësh betimin që je i gatshëm të japësh edhe jetën për Republikën e Shqipërisë, për popullin shqiptar. Dhe ne jemi të bindur që në Qarkun e Shkodrës, por edhe në Qarkun e Lezhës, kemi plot djem dhe vajza, që janë të gatshëm të jenë pjesë e FARSH dhe që natyrisht janë të gatshëm të sakrifikojnë për vendin tonë...”

Z. Koçi, në fjalimin e tij, shpreh falënderim dhe mirënjohje për komandantin e b1kFT nënkolonel Ali Malin, për organizimin e Ditës së Hapur dhe për elementët e përfshirë në të, sidomos për stacionet e mësimoreve treguese.

Në përfundim të fjalës së tij, zëvendësministri i Mbrojtjes i ftoi të



rinjtë për t'u bërë pjestarë e FARSH, duke i garantuar ata se në FARSH do të gjejnë një punë dinjitoze, për të ardh-

men e tyre. Nga ana e tij, komandanti i Batalionit të Parë të Këmbësorisë nënkolonel Ali Mali duke bërë një

spjegim të përmbledhur për të pranishmit në lidhje me demonstrimet që ata ndoqën, shprehu kënaqësinë e tij për



praninë e të rinjve të shumtë, që kishin mbushur repartin këtë ditë. Me tej, ai bëri një përmbledhje të misionit dhe angazhimit të repartit, që ai drejton, si në misionet brenda vendit në kuadër të emergjencave civile ashtu edhe në misionet paqeruajtëse jashtë vendit. Nënkolonel Mali, iu bëri thirrje të rinjve të bashkohen me radhët e Forcave të Armatosura, duke i garantuar ata se do të ndihen krenarë për punën që do të bëjnë dhe për edukimin që do të marrin. Të njëjtën ftesë për të rinjtë përsëriti edhe komandanti i QPR kolonel Isuf Hamati, i cili i siguroi ata se emocionin e përjetuar gjatë demonstrimeve, do ta ndjejnë dyfish nëse do të jenë pjesë e Forcave të Armatosura. Më pas, të pranishmit vizituan standat me armatimin dhe pajisjet në përdorim nga efektivi i Batalionit I të Këmbësorisë të Forcës Tokësore.

## BATALIONI I MBËSHTETJES RAJONALE-KUKËS

## Stërvitja kompaktësuese “Drini 2019”

Detashmenti i Mbrojtjes Rajonale (DMR) Kukës i Batalionit të Mbështetjes Rajonale, të Komandës Mbështetëse zhvilloi stërvitjen “Drini 2019” për përballimin e Emergjencave Civile në raste zjarri, përmbajtje, tërmeti dhe aksidente të ndryshme. Stërvitja kompaktësuese Drini 2019 u zhvillua ndërmjet fshatit Drinas dhe Ramhas Kukës dhe zgjati tre ditë. Qëllimi i stërvitjes ishte në reagimin, kompaktësimin, rritjen profesionale të togës së kërkim-shpëtimit të DMR Kukës si dhe përballimin me sukses të vështirësive në shpëtimin e jetës së njerëzve, gjësë së gjallë, vlerave materiale, pasurive ekonomike e kulturore, si dhe sigurimin e mbështetjes së nevojshme për autoritetet civile të organeve të pushtetit vendor dhe lokal.

Gjatë kësaj stërvitje, trupat e angazhuara me në krye komandantin e DMR Kukës major Kastriot Imeri, treguan se, pavarësisht terrenit ku stërviten, shkallës së vështirësisë, kjo nuk i pengon ata të kryejnë më së miri misionin dhe detyrat e marra në situata të ndryshme si në shuarjen e zjarreve, evakuimin e personave të përmblytur ashtu edhe në dhënien e ndihmës së parë mjekësore ... Gjatë



demonstrimit stërvitja u ndoq së afërmi nga prefekti i qarkut të Kukësit z. Zenel Kuçana, komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ndrëçim Sallaku, shefi i Shtabit i KM kolonel Shkëlqim Çela, si dhe përfaqësues të pushtetit vendor dhe lokal.

Komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ndrëçim Sallaku në fjalën e tij, theksoi se duhet të funksionojë më mirë edhe organizimi më i shpeshtë i këtyre stërvitjeve, ku të përfshihen dhe

strukturat e emergjencave civile të prefekturës. Ai falënderoi përfaqësuesit e pushtetit vendor veçanërisht prefektin e këtij qarku, z. Kucana, gjithashtu falënderoi edhe efektivat e togës së kërkim - shpëtimit për demonstrimin dinjitoz të stërvitjes në ndihmë të komunitetit. Stërvitje të tilla do t'i shërbejnë komunitetit në raste nevojash dhe gjithashtu ju siguroj se Komanda Mbështetëse do jetë gjithmonë e gatshme të japë kontributin e saj në ndihmë të fatkeqësive natyrore, përfundoi fjalën e tij gjeneral brigade Sallaku. Prefekti i qarkut të Kukësit z. Zenel Kuçana, falënderoi efektivet e KM për stërvitjen dhe siguroi se bashkëpunimi strukturat e pushtetit vendor me FARSH do të jenë gjithmonë në rritje. Veprimet dhe vendosja e togës në situata pothuajse reale si në ndihmën e parë në rast aksidentesh, përmbajtje, evakuim njerëzish, po ashtu edhe në shuarjen e zjarreve tregoi edhe njëherë përkushtimin dhe punën në skuadër të efektiveve tanë. Kjo stërvitje tregoi përgatitjen e lartë të efektiveve të DMR dhe togës së kërkim-shpëtimit për zgjidhjen e situatave të ndryshme emergjente. Në stërvitjen e organizuar morën pjesë 30 efektive të DMR Kukës, 4 mjete të kalueshmërisë së lartë, 1 autoambulancë, 1 zjarrfikëse, si dhe 2 motobarka.

## Gjeneralbrigade Fadil Hadërgjonaj-Gjeneralbrigade Bajram Begaj

# Konsolidim i bashkëpunimit midis FARSH dhe FSK-së

*Gjeneralbrigade Fadil Hadërgjonaj, komandanti i BrRSH të FSK-së, vizitë në KDS*

Në kuadër të fillimit të fazës egzekutive të stërvitjes 3 shkallëshe komando-shtabi "Shqiponja-19", komandanti i BrRSH të FSK, gjeneralbrigade Fadil Hadërgjonaj, zhvilloi një vizitë njohëse njëditore në mjediset stërvitore të KDS.

Gjeneralbrigade Hadërgjonaj, u prit në një takim të ngrohtë e miqësor nga komandanti i KDS, Gjeneralbrigade Prof. Asoc. Bajram Begaj. Pasi ju uroi mirëseardhjen, Gjeneral Begaj, e njohu Komandantin e BrRSH të FSK, me zhvillimet më të fundit në institucionin e KDS me theks në pjesën stërvitore të programeve e kurrikulave akademike dhe konkretizimin e tyre në stërvitjet e këtij lloji, sic është dhe stërvitja "Shqiponja 19". Gjeneral Begaj, vlerësoi punën, përkushtimin, angazhimin e disiplinën dhe të personelit ushtarak kosovar të b2 të Regimit të Shpejtë të Forcave të Sigurisë së Kosovës, pjesëmarrës në stërvitje.

Nga ana e tij, Gjeneralbrigade Hadërgjonaj, falenderoi për mikpritjen, duke u shprehur se është i kënaqur që ndodhet në institucionin më të lartë arsimor ushtarak shqiptar. "Këto lloj stërvitjesh dhe bashkëpunimi ynë i përbashkët edhe në këtë fushë-ka vijuar komandanti i BrRSH të FSK, do i shërbejë më së miri orientimit në zhvillimin e FSK në përgjithësi, sidomos në kushtet aktuale që ndodhet, tashmë që u zyrtarizua si forcë e armatosur, dhe më detajisht në zhvillimin e kapaciteteve trajnuese e stërvitore simuluese të FSK, që po zhvillohen kryesisht me batalionin e pare dhe te dytë të BrRSH".

Në këtë takim, nën një frymë të ngrohtë dhe vllazërore vijuan diskutimet mbi thellimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit dypalësh midis FARSH dhe FSK, konkretisht në fushën e arsimimit e trajnimit ushtarak edhe për stërvitje të llojit simualtiv, nëpërmjet qëndrës së simulimit, stërvitje që minimizojnë kostot e trajnimit, por dhe me interes të përbashkët e reciprok në interes të rritjes së kapaciteteve trajnuese.

Komandanti i BrRSH të FSK, gjeneralbrigade Fadil Hadërgjonaj, nëpërmjet një prezantimi në Qendrën e Simulimit në KDS, u njoh në vija të përgjithshme me atë cka QS përfaqëson, sistemin stërvitor dhe simulimin në këtë qendër dhe në vijimësi me



një informacion të përgjithshëm mbi objektivat e stërvitjes dhe trajnimit, skenarin e saj, strukturën etj. Më pas, gjeneral Hadërgjonaj vizitoi të gjitha ambientet stërvitore të ndara sipas audiencave stërvitore të saj.

Gjatë ditëve të zhvillimit të kësaj stërvitje Akademia e Forcave të Armatosura, b1k i Forcave Tokësore, b2 e Regimit të Shpejtë i Forcave të Sigurisë së Kosovës dhe Qendra e Simulimit do të punojnë së bashku për të zbatuar, vlerësuar dhe mësuar në mënyrë korrekte nga ky aktivitet. Stërvitja "Shqiponja-19" është një stërvitje që programohet dhe drejtohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe ka si qëllim të aftësojë kursantët e KLO dhe KKSHP në rolin e oficerit të shtabit të CJTF dhe BrMN, si dhe shtabin e b1k të Forcës Tokësore dhe b2 të Regimit të Shpejtë të Forcave të

Sigurisë së Kosovës, për procesin e planëzimit në nivel operacional, Procedurën e Vendimmarrjes Ushtarake (MDMP) në nivel taktik dhe dinamikën e zhvillimit të luftimit, duke zbatuar konceptet doktrinare të NATO-s, në rast krizash. Stërvitja "Shqiponja -19" synon të zbatojë konceptet doktrinare për përdorimin e forcave ushtarake në Operacionet e Mbështetjes së Paqes, koordinimi dhe bashkëveprimi me aktorët civilë (pushtetin qendror/lokal/OJF/OQ/Agjensi) e ushtarakë brenda zonës së operacionit; ngritjen, funksionimin dhe më pas planizimin dhe zhvillimin e një operacioni në vendkomandë sipas niveleve, si dhe familjarizimin e strukturave të b1k të Forcës Tokësore dhe b2 të Regimit të Shpejtë të Forcave të Sigurisë së Kosovës në zhvillimin e stërvitjes me ndihmën e kompjuterit.

Kursi i Lartë i Oficerit (KLO) në Bruksel-Belgjikë

## Vizitë në Selinë e NATO-s dhe Shtabit Ushtarak të BE

Në kuadër të zbatimit të programit mësimor të të Kursit të Lartë të Oficerit (KLO), të Akademisë së Forcave të Armatosura, në datat 15-17 maj 2019, u zhvillua një vizitë mësimore në institucionet ndërkombëtare të sigurisë në Mbretërinë e Belgjikës, NATO dhe EUMS. Vizita mësimore u drejtua nga Komandanti Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade prof. asoc. Bajram Begaj dhe në të morën pjesë Zv/Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, Shefi i Departamentit të Strategjisë dhe Historisë, pedagogu i lëndës si dhe kursantët e KLO.

Qëllimi i vizitës ishte studimi, njohja, analizimi dhe vlerësimi i rolit të NATO-s në mjedisin bashkëkohor të sigurisë dhe përbashkëta me sfidat e së ardhmes, si dhe njohja e aspektit ushtarak të Bashkimi Evropian në kuadër të politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes, misionet dhe operacionet aktuale ku Bashkimi Evropian është i përfshirë.

Në selinë e NATO-s kursantët e KLO morën leksione mbi Prioritetet Kyçe të NATO-s, Politikat e Mbrojtjes dhe Planëzimit në NATO, Planet dhe Operacionet aktuale të NATO-s, si dhe Sfidat e reja të Sigurisë ndaj Aleancës.

Gjatë kësaj vizite u zhvillua një takim edhe me Ambasadorin e Shqipërisë në NATO, Zoti Visho Ajazi dhe Përfaqësuesin Ushtarak të Republikës së Shqipërisë në NATO, gjeneral major Nazmi Cahani.

Pjesë e programit ishte edhe vizita me stafin ushtarak në Selinë e Shtabit Ushtarak të BE, EUMS- Bruksel, ku u pritën në takim nga gjeneral major Giovanni Manione, Zv/Shef i Stafit Ushtarak të Bashkimit Evropian. Në takimet e zhvilluara me stafin ushtarak të BE kursantët u njohën me dimensionin ushtarak të BE në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes, si dhe me misionet dhe operacionet aktuale të BE. Prezantimet e zhvilluara u shoqëruan me diskutime dhe pyetje-përgjigje nga ana e kursantëve mbi temat e trajtuara. Në përfundim të takimeve dhe prezantimeve komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade prof. asoc. Bajram Begaj, falenderoi referantët për prezantimet interesante dhe shumë informative, si dhe drejtuesit dhe përfaqësuesit e Republikës së Shqipërisë pranë kësaj selie për mikpritjen.



Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes

## Zhvillohet stërvitja 3 shkallëshe "Shqiponja -19"

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes u zhvillua stërvitja 3 shkallëshe "Shqiponja-19". Kjo stërvitje ishte projektuar dhe u zhvillua nga stafi i Akademisë së Forcave të Armatosura, kryesisht kursantët e KLO, KKSHP, në bashkëpunim me b1k e Forcave Tokësore, b2 e Regimit të Shpejtë të Forcave të Sigurisë së Kosovës dhe Qendrën e Simulimit në KDS.

"Shqiponja-19" ishte një stërvitje që programohet dhe drejtohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe ka si qëllim të aftësojë kursantët e KLO dhe KKSHP në rolin e oficerit të shtabit të CJTF dhe BrMN, si dhe shtabin e b1k të Forcës Tokësore dhe b2 të Regimit të Shpejtë të Forcave të Sigurisë së Kosovës, për procesin e planëzimit në nivel operacional, Procedurën e Vendimmarrjes Ushtarake (MDMP) në nivel taktik dhe dinamikën e zhvillimit të luftimit, duke zbatuar konceptet doktrinare të NATO-s, në rast krizash.

"Shqiponja -19" synonte të zbatonte konceptet doktrinare për përdorimin e forcave ushtarake në Operacionet e Mbështetjes së Paqes, koordinimin dhe bashkëveprimin me aktorët civilë (pushtetin qendror/lokal/OJF/OQ/Agjensi) e ushtarakë brenda zonës së operacionit; ngritjen, funksionimin dhe më pas planizimin dhe zhvillimin e një operacioni në



vendkomandë sipas niveleve, si dhe familjarizimin e strukturave të b1k të Forcës Tokësore dhe b2 të Regimit të Shpejtë të Forcave të Sigurisë së Kosovës në zhvillimin e stërvitjes me ndihmën e

kompjuterit. Gjatë ditëve të zhvillimit të kësaj stërvitje Akademia e Forcave të Armatosura, b1k e Forcave Tokësore, b2 e Regimit të Shpejtë i Forcave të Sigurisë së Kosovës dhe Qendra e Simulimit kanë punuar së bashku për të planifikuar, zbatuar, vlerësuar dhe mësuar në mënyrë korrekte nga ky aktivitet. Për zhvillimin e stërvitjes u ndoqën procedurat e përkrahura në Direktivën e Stërvitjes të NATO-s Bi-SC 75-3 dhe Direktivën e Stërvitjes DS-7-1; COPD, MDMP etj. Këto dokumente janë udhëzime gjithëpërfshirëse rreth planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të një stërvitje ushtarake të NATO-s. Në interes të kësaj stërvitje me qëllim marrjen e masave për mbarëvajtjen e saj, Departamenti i Operacioneve dhe Qendra e Simulimit kanë zhvilluar 4 konferenca planëzuese për të arritur në planifikimin dhe ekzekutimin e saj.

## Sipas standardeve të NATO-s dhe IAMSAR

U zhvillua stërvitja e koduar  
"Durrës-SAREX 2019"

*Në stërvitje morën pjesë Forca Detare me anijet "Iliria", "Era", P-118, P-01 dhe "Drini", grupi i bordingut, Forca Ajrore me një helikopter, Antikontrabanda dhe policia Kufitare me një mjet*

Paraditen e datës 23 maj 2019 në rajonin e gjirit të Durrësit-Kepi i Palit dhe ambientet e Komandës së Forcës Detare u zhvillua stërvitja e koduar "Durrës-SAREX 2019". Qëllimi kryesor i kësaj stërvitje është promovimi i bashkëpunimit dhe rritja e ndërveprueshmërisë ndërmjet mjeteve detare të FD, mjeteve ajrore të FAj dhe institucioneve tona detare që kanë interesa në det, duke zbatuar procedurat e zbatimit të ligjshmërisë detare për operacionet e ndalimit detar dhe kërkim-shpëtim (SAR), bazuar në skenarë të supozuar. Gjithashtu rritja e nivelit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimeve ndërmjet strukturave pjesëmarrëse në stërvitje, në kryerjen e procesit të planëzimit dhe vendimmarrjes sipas procedurave standarde të NATO-s dhe IAMSAR.

Paraprakisht ishin marrë masa për trajnimin dhe stërvitjen e forcave pjesëmarrëse për të zhvilluar operacione të ndalimit detar, kërkim-shpëtim {SAR} në det në përgjigje të fatkeqësive detare, krizave humanitare dhe emigrimit. Për të arritur këto objektiva, më parë u bë planëzimi dhe kryerja e stërvitjes së kombinuar me institucionet që kanë interesa në det, ndërveprueshmërinë dhe kom-

petencën e drejtuesve, personelit dhe mjeteve në nivel taktik dhe stërvitje në kushte reale. Në stërvitje morën pjesë me personel dhe mjete, Forca Detare (që ishte dhe organizatore e stërvitjes), 4 mjete, anija "Iliria", anija "Era", P-118, P-01, "Drini", skafi i anijes "Iliria", grupi i bordingut, Forca Ajrore me një helikopter, Antikontrabanda dhe policia Kufitare me një mjet. Zëvendëskomandanti i Forcës Detare, kapiten i Rangut I Artur Mecollari sqaroi se krahas përmirësimit të elementëve të kësaj stërvitje në krahasim me vitin e kaluar, u zgjerua rajoni i stërvitjes, ndërkohë që

u testuan kapacitetet komunikuese të anijeve të FD me helikopterët e FAj dhe mjeteve të institucioneve pjesëmarrëse. Gjithashtu u realizua njohja e situatës detare në rajonin e stërvitjes duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion, kryerja e bordimit në det, zhvillimi i operacioneve të kërkim - shpëtim dhe operacioneve të ndalimit në det, etj. Stërvitja u zhvillua në dy plane, në sallën operacionale të FD dhe në rajonin e caktuar në det. Në sajë të masave paraprake, bashkëpunimit ndërinstitutional dhe trajnimeve të vazhdueshme, stërvitja "DURRËS-SAREX-2019", ja arriti qëllimit.

## TRUPAT TONA USHTARAKE NË KROACI

Zhvillohet stërvitja  
"Immediate Response-19"

Në Sluj të Kroacisë po zhvillohet stërvitja "Immediate Response-19", ku marrin pjesë shtetet si: Shqipëria, Kroacia dhe Kosova. Kjo stërvitje është fillesa e sagës së stërvitjeve të koduara "Black Sea Rotation", e iniciuar nga ushtria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe që do të pasojë me stërvitjet në rajon përkatësisht në Maqedoninë e Veriut, Slloveni dhe Rumani. Në stërvitjen "Immediate Response - 19", Forcat e Armatosura të RSH marrin pjesë me 32 efektivë të Togës së Dytë të Kompanisë së Dytë të Forcës Tokësore dhe kjo togë i shërben dhe Kompanisë së Dytë që Shqipëria ka deklaruar si të gatshme të trupave të KFOR për vitin 2019.

## SHKOLLA E TRUPËS, BUNAVI

Në Bunavi vazhdon stërvitja  
individuale e avancuar

Prej datës 06.05.2019 në ambientet e Shkollës së Trupës, Bunavi, ka nisur cikli stërvitor me kursin e Stërvitjes Individuale të Avancuar në specialitetet "Këmbësori", "Ndërlidhje", "Logjistikë" dhe "Policia Ushtarake", ku pjesë e këtij efektivit që po stërviten janë dhe 10 femra. Programi i Stërvitjes Individuale të Avancuar zgjatë 50 ditë, e ndarë në 3 periudha: "jeshile", "blu" dhe "kuqe". Në këtë kurs zhvillohen gjithsej 6 detyra qitje me armët e këmbësorisë dhe në përfundim zhvillohet testimi i detyrave dhe Ushtrimi Stërvitor Fushor 3 ditor (marshim në këmbë dhe me pajime) në një distancë totale 35 deri në 40km.



## NË BAZËN DETARE TË PASHALIMANIT NË VLORË

## Zhvillohet stërvitja trepalëshe "Joni-19"

*Në këtë stërvitje multinacionale, u angazhuan efektivë nga Batalioni i Forcave Speciale të FT, grupe nga Forcat Speciale maqedonase dhe bullgare*

Në bazën detare të Pashalimanit në Vlorë u zhvillua më 22 maj ceremonia e fillimit të stërvitjes trepalëshe "Joni-19", stërvitje e cila ka përfunuar me 30 maj 2019. Në këtë stërvitje multinacionale, u angazhuan efektivë nga Batalioni i Forcave Speciale të Forcës Tokësore si dhe grupe nga Forcat Speciale maqedonase dhe bullgare.

Në ceremoninë e hapjes së "Joni-19" mori pjesë si i deleguar nga Shtabi dhe Komanda e Forcës Tokësore, shefi i Operacioneve dhe Stërvitjes së Forcës Tokësore, kolonel David Rroku si dhe oficerë nga degët e kësaj njësie. Duke uruar pjesëmarrësit edhe ne emër të komandantit të Forcës Tokësore gjeneral brigade Mulla për këtë iniciativë dhe aktivitet tepër domethënëse, kolonel Rroku shprehu besimin se kjo stërvitje do të ndikojë së tepërmi

në rritjen e profesionalizmit të Forcave Speciale, duke rritur njëkohësisht aftësitë e tyre ndërvepruese dhe bashkëpunuese, në një mjedis multinacional.

Ushtrimi stërvitor "Joni-19" u kryhen në kuadër të marrëveshjes trepalëshe të ministrave të Mbrojtjes për rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e eksperiencave midis Forcave të Armatosura. Fokusi kryesor gjatë këtij trajnimit, ishte në tek operacionet ujore. Një mbështetje të madhe ju dha kësaj stërvitje edhe nga Qendra e Zhytjes së Forcës Detare. Temat kryesore që përmbante programi stërvitor ishin: zhytje në grupe 2, 4, 6 zhytës; balancim; ecje në ujë në distanca të shkurtra; praktikimi i shenjave të zhytjes; praktikimi i ushtrimeve nënujore (heqje maske, rokator, jelekun e zhytjes); veprime praktike nënujore si zhytje thellësie

10-15 m; praktikimi i hedhjeve nga gomonia, lundrim me busull, distanca 150-200 m në drejtim të objekteve të caktuara, lundrim me busull, distanca 300-500 m në disa objekte të caktuara, hedhje nga gomonia në grup 2, 4, 6 zhytës, zhytje thellësie në pamje të kufizuar shikueshmërie nënujore, thellësia maksimale 20 m, hedhje nga gomonia në grup 2, 4, 6 zhytës, zhytje thellësie, praktikimi i ushtrimeve nënujore, ecje në distancë me busull, përdorimi i shenjave të komunikimit nënujor, infiltrim - eksfiltrim, shpërthimi nënujor thellësia maksimale 25 m. "Joni-19" ka vazhduar deri në datën 30 maj dhe u përmbyll me një demonstrim stërvitor, nga Forcat Speciale të tre shteteve pjesëmarrëse.

**Major Edvin Zguro**  
Specialist i BCU, bFS

# Mario Trupja

NGA: RUDINA DERVISHI

## Një oficer shqiptar diplomohet në Akademinë e Marinës Amerikane

**A**kademia Detare e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në Annapolis (Akademia Detare e SHBA është e vendosur në Annapolis, Maryland në brigjet e lumit Severn dhe në brigjet e Gjirit të Chesapeake) është ndër institucionet më prestigjioze që përgatit kuadro-elitë të ushtrisë amerikane. Mario Trupja, është studenti i dytë shqiptar që diplomohet nga kjo akademi dhe që do të shërbejë me forcat detare shqiptare në kuadër të një programi që mundëson aftësimin e një brezi të ri ushtarakësh në vendet antare të Natos.

Ceremonia e diplomimit në Akademinë e Marinës Amerikane është një eveniment jo si shumë të tjerë, në këtë sezon të përfundimit të studimeve për shumë studentë amerikanë dhe ndërkombëtarë.

Mario Trupja, nga Shqipëria, është ushtaraku i dytë i diplomuar në këtë shkollë prestigjioze. Ai ecën krenar mes 1052 studentëve që përfunduan studimet këtë vit në këtë akademi, pas një pune të mundimshme katër vjeçare.

“Ka qenë e vështirë. Ka patur etapat e veta. Shoku i parë kulturor, ushqimi, shoqëria, gjuha, duhet të mësoheshe në fillim me mënyrën e jetesës. Plus që akademja kishte traditat e veta që duhet të mësohesha, trajtimi, orari shumë i ngjeshur... Normalisht tani është një moment shumë i veçantë, është momenti kulminant i gjithë asaj pune” - thotë Mario.

Shkollimi në Akademinë e Marinës Amerikane ndërthur një stërvitje të fortë fizike dhe punë akademike rigoroze në një degë si ajo e inxhinierisë dhe arkitekturës detare ku u diplomua, Mario.

“Me stërvitjen mësoheshe, sepse vetë ambjenti të kalit. Por pjesa akademike gjithmonë të ofron një sfidë më shumë. Dega ime ishte arkitekturë dhe inxhinieri navale, që ka të bëjë me dizenjimin e anijeve, mjeteve lundruese dhe paçka që më pëlqen shumë ajo që bëja, prapë është e vështirë, kështu që ajo besoj ka qenë sfida më e madhe”, thotë Mario.

„Mali i Zi ishte dhe mbeti aleat i rëndësishëm për ne, partner i afërm i cili pa nguruar na ka mbështetur në rrugën tonë drejt Aleancës. Ju falënderoj sinqerisht për ratifikimin e shpejtë të Protokollit të Anëtarësimit, që tregon se Ballkani jeton në një kohë të re në të cilën fqinjët, më të afërt dhe më të largët, janë bashkëpunëtorët më të ngushtë”, tha ministrja.



Shekerinska theksoi se bashkëpunimi me Malin e Zi nuk është vetëm një floskulë-ai është i dukshëm përmes stërvitjeve të përbashkëta, arsimimit të kadetëve për nevojat e Armatës së Malit të Zi në Akademinë Ushtarake në Shkup, pjesëmarrja e kadetëve nga Mali i Zi në Kampusin Veror në Maqedoninë e Veriut, lloje të ndryshme të kurseve, trajnimeve dhe bisedimeve eksperte në të dy vendet.

Ministrja në takim u ndal edhe në

stërvitjen e ardhshme që do të realizohet në “Krivollak”, “Goditje Vendimtare”, pjesë e të cilit do të jenë edhe pjesëtarët e ushtrisë malazeze. “Kjo stërvitje do të zhvillojë më tej ndërveprimin tonë dhe do të dëshmojë se pjesëtarët e dy ushtrive funksionojnë plotësisht në përputhje me standardet e NATO-s”, tha ministrja Shekerinska.

Ajo shtoi se stërvitja “Goditje Vendimtare”, në të cilën, përveç Maqedonisë së Veriut dhe SHBA-së, të cilët marrin pjesë me kontingjentet më



të mëdha, marrin pjesë forca ushtarake nga Mali i Zi, Bullgaria, Shqipëria dhe Lituania.

Takimi ministror u mbajt në Podgoricë, në kuadër të takimit të përbashkët të Qeverisë së Malit të Zi dhe qeverisë së Maqedonisë së Veriut, ku zëvendëskryeministrja dhe ministrat e mbrojtjes, Shekerinska dhe homologu i saj malazez Predrag Boshkoviç nënshkruan në emër të dy qeverive Marrëveshjen Ndërshtetërore për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Informatave të Klasifi-

kuara.

Marrëveshja gjithashtu rregullon përfundimin dhe zbatimin e kontratave të klasifikuara, procesin e realizimit të vizitave nga përfaqësues të secilës prej Palëve Kontraktuese, të cilat përfshijnë aksesin në informacionin e klasifikuar, si dhe mënyrën e veprimit të palëve në rast të shkeljes së dispozitave për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar. Marrëveshja parashikon që secila palë do të bartë kostot e saj në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

## Gjeneral Gjurçinovski në Komandën e Përbashkët të NATO-s

Shefi i Shtabit të Ushtrisë të Maqedonisë së Veriut, gjeneral-lejtnant Vasko Gjurçinovski, pas pjesëmarrjes së tij në Komitetin Ushtarak të NATO-s në Bruksel, zhvilloi më 23 maj, një vizitë zyrtare në Komandën e Përbashkët të NATO-s në Brunsum.

Gjatë qëndrimit të tij në Brunsum, gjeneral Gjurçinovski pati një takim me komandantin e këtij komande të përbashkët, gjeneralin Ricardo Marcio, pas së cilës ai zhvilloi edhe një takim pune me personelin kyç të komandës së përbashkët.

Në takim u diskutua mbi aktivitetet e vazhdueshme dhe ato që duhet të realizohen në të ardhshmen në procesin e integritimit të plotë të ushtrisë maqedonase në strukturat e NATO-s, si dhe aktivitetet e përbashkëta ushtarake të planifikuara me NATO.

Ndër të tjera, u diskutua për



kontributin e mundshëm të njëjve të ushtrisë maqedonase në Forcën e Reagimit të Shpejtë të NATO-s pas anëtarësimit të plotë në NATO.


Në fund të takimit, gjenerali Gjurçinovski është takuar gjithashtu

me përfaqësuesin e Mbretërisë së Bashkuar në NATO, gjeneral-lejtnant Sir George Norton, ku është diskutuar bashkëpunimi ushtarak dypalësh dhe perceptimi i mundësive për aktivitetet të përbashkëta.

## Operacionet speciale në pëputhje me standartet e NATO-s

Delegacioni i NATO-s Selia e Operacioneve Speciale të udhëhequr nga Zëvendës Admirali Colin Kilraine u përshëndet nga oficeri komandues i Regjimentit të Operacioneve Speciale gjenerali i Përgjithshëm i Brigadës Hadzi Janev. Qëllimi i vizitës së këtij delegacioni të lartë ishte shkëmbimi i informacionit mbi transformimin dhe integrimin e forcave speciale të ushtrisë pas anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i mundësitë për bashkëpunim. Komandanti i SOS, në përputhje me udhëzimet e udhëheqjes politike dhe ushtarake, e njoftoi zëvendësadmiralin rreth qëllimeve të tij dhe qëllimeve të dëshiruara që kishte për zhvillimin e forcave speciale në Republikën e Maqedonisë Veriore. Nënadmirali demonstroi aftësitë e arritura të ndërveprimit të njësisë. Zëvendës Admirali Kilraine dhe anëtarët e tjerë të delegacionit ishin të kënaqur me demonstratën nga njëjësia dhe presin integrimin e shpejtë dhe efikas dhe transformimin e forcave speciale të ushtrisë në të ardhmen në strukturat e NATO-s.





Gjeneral Brigade Klafus, falënderoi ministrin Bosković për vizitën e tij dhe shprehu kënaqësinë që anëtarët e Kontigjentit të Malit të Zi tregojnë përgatitje tejet profesionale për kryerjen e detyrave. Në këtë mënyrë, tha komandanti, ata përfaqësojnë shtetin e tyre si një aleat i besueshëm.



Ministri Boshkovic në Afganistan

# Gjeneral Klafusom: Prezenca ndërkombëtare është e nevojshme

*Mali i Zi, si një anëtar i NATO-s, kontribuon në politikën e Aleancës për sigurimin e stabilitetit në Afganistan.*

Ministri i Mbrojtjes Predrag Boskovic gjatë vizitës në Afganistan, më 20 maj, në bazën Marmal u takua me komandantin e Komandës së Veriut, gjeneral brigade, gjermanin Gerhard Ernst-Peter Klafusom.

Boskovic falënderoi gjeneralin Klafusom për mbështetjen e trupave malazeze nga kontingjenti gjerman gjatë realizimit të detyrave në misionin Resolute Support. Ai shprehu besimin se kjo forcë ndërkombëtare e përbërë nga aleatët dhe partnerët është garantuesi më i mirë i sigurisë dhe se prania e tyre është ende e nevojshme.

Ministri kujtoi bashkëbiseduesin e tij se “trupat e Malit të Zi në Afganistan për herë të parë janë dërguar në vitin 2010 dhe që atëherë ne jemi vazhdimisht e pranishme, së pari në ISAF, ku është rritur gradualisht numri e ushtarëve tanë”. Ai tha se Mali i Zi, si një anëtar i NATO-s, po përpiqet të kontribuojë maksimalisht në politikën e Aleancës për hartimin e stabilitetit.

Gjeneral Brigade Klafus, falënderoi ministrin Bosković për vizitën e tij dhe shprehu kënaqësinë që anëtarët e Kontigjentit të Malit të Zi tregojnë përgatitje tejet profesionale për kryerjen e detyrave. Në këtë mënyrë, tha komandanti, ata përfaqësojnë shtetin e tyre si një aleat i besueshëm. General Klafus, tha se gjendja e sigurisë në këtë zonë brenda së cilës funksionon Komanda e Veriut vlerësohet e qëndrueshme, duke shtuar se realizimi i qëllimit themelor të misionit shoqërohet me rezultate të dukshme, por prezencja e forcave ndërkombëtare është akoma e nevojshme.

Ndërkohë Ministri Boshković u takua në mbrëmjen e datës 20 maj me komandantin e kontigjentit kroat, brenda të cilit operon kontingjenti malazez, kolonelin Dragisha Konso. Boskovic ka falënderuar kolonelin Konso për mbështetjen që ushtarët kroatë japin për ushtarët malazezë dhe vuri në dukje se ky nivel i lartë bashkëpunimi, në kuadër të misionit të trupave, është një tjetër konfirmim i bashkëpunimit të shkëlqyer midis dy ministrive të mbrojtjes, si dhe dy ushtrive. Koloneli Konso gjatë bisedës me ministrin malazez, foli për situatën aktuale, si dhe dinamikën e përbushjes aktuale dhe të planifikuara të detyrave në Afganistan. Ai vlerësoi nivelin jashtëzakonisht të lartë të profesionalizimit të ushtarëve malazezë, me besimin se të dy kontingjentet u përgjigjen plotësisht sfidave dhe detyrave në misionin Resolute Support.

Nërkohë ministri Boshkovic, ka organizuar më 21 maj, në Marmal të Afganistanit një pritje modeste me rastin e 21 majit, Ditës së Pavarësisë së Malit të Zi. Ministri ka përshëndetur



tur Kontingjentin e Malit të Zi në Afganistan dhe ka shprehu respekt të thellë për guximin e tyre profesional. Ai i përgëzoi ata në 21 maj, ai një nga datat më të rëndësishme në historinë e re të Malit të Zi. Ministri Boskovic theksoi se të gjitha konsideratat se ai kishte dëgjuar nga eprorët e tyre gjatë qëndrimit të tij në bazën Marmal ishin

të jashtëzakonshme, në sajë të tyre për të gjitha ato që kanë bërë për tre muajt e fundit për të mirën e popullit të Afganistanit, si dhe për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në këtë vend. Përveç anëtarëve të Kontigjentit malazez në misionin Resolute Support, ishin edhe përfaqësuesit e forcave ndërkombëtare në mision.

## Zhvillohet konferenca “Koalicioni kibernetik 2019”

Nga data 21 deri 24 maj u zhvillua në Podgoricë konferenca tre-ditore për Stërvitjen e NATO-s “Kualicioni kibernetik 2019”, e cila u organizua nga Ministria e Mbrojtjes e Malit të Zi. Në konferencë ishin të pranishëm rreth 100 ekspertë kibernetike nga vendet anëtare dhe vendet partnere të NATO-s. Drejtori i Drejtorisë për burimet materiale në Ministrinë e Mbrojtjes, Alma Ljuljanaj-Jovičević tha, duke hapur konferencën, se “aktiviteti i përbashkët në teren është çelësi për një luftë të suksesshme kundër sfidave të sigurisë”. Kjo stërvitje ishte një mundësi e mirë për trajnimin dhe testimin e mbrojtësit tanë kibernetik dhe, më e rëndësishmja, për të ndërtuar besimin e ndërsjellë dhe shkëmbimin e informacionit,” tha drejtori Ljuljanaj-Jovičević.

Ajo kujtoi se Mali i Zi u bashkua me “Koalicionin Kibernetik”, vitin e kaluar si një vëzhgues, por që nga ky vit e tutje, Mali i Zi do të marrë pjesë aktive në këtë stërvitje, jo vetëm si vëzhgues.

Drejtori Ekzekutiv i Koalicionit Kibernetik Robert Buckles përshëndeti Konferencën në emër të Komandës së Aleancës për Transformimin e NATO-s (ACT). Ai veçanërisht falënderoi faktin se Konferenca e mbajtur në Mal të Zi, anëtarë më i ri i NATO-s, ishte pikërisht në Ditën e Pavarësisë. “Aleanca jonë po përballet me sfida të mëdha në fushën e sulmeve kibernetike, të cilat nuk mund ti kundërshtojmë individualisht. Duhet të përsosim ushtrimet që mund të testojnë kapacitetet tona për përgjigjet kombëtare, për të mbrojtur rrjetin tonë brenda zonave tona, duke u integruar me të tjerët”, tha Buckles. Konferenca u mirëprit edhe nga ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Malin e Zi, Alison Kemp. Qëllimi i “Kualicionit Kibernetik 2019” është të përmirësojë koordinimin dhe bashkëpunimin midis NATO-s dhe aleatëve, të forcojë aftësinë për të mbrojtur hapësirën kibernetike të Aleancës dhe për të kryejë operacione ushtarake në domenin kibernetik.

## Gjeneral brigade Dakiç në Komitetin Ushtarak të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë të Malit të Zi, gjeneral brigade Dragutin Dakiç ka marrë pjesë në sesionin e 181-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s, organit më të lartë ushtarak i Aleancës, që u mbajt në Bruksel. Sesioni u hap nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, i cili theksoi se uniteti i Aleancës është forca e saj e madhe. Gjatë fjalës së tij, Sekretari i Përgjithshëm ka informuar Shefat e Shtabit të vendeve antare të NATO-s, lidhur me situatën aktuale politike dhe ka bërë një përmbledhje të sfidave kryesore strategjike me të cilat përballet Aleanca. Pas fjalimit hyrës nga Sekretari i Përgjithshëm, Shefat e Shtabit miratuan një Strategji të re Ushtarake të NATO-s. Temat kryesore të konferencës ishin miratimi i strategjisë së zhvillimit, udhëzimet e reja të përgatitjes dhe udhëzime për parandalimin dhe mbrojtjen, situatën e sigurisë në Ukrainë, projektet për ngritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, si dhe misionet e zbatuara nga NATO-ja në zonën e saj të përgjegjësisë. Komiteti Ushtarak i NATO-s ka përcaktuar detyrat që lidhen me operacionet e NATO-s dhe rekomandimet ushtarake ndaj Këshillit të Atlantikut të Veriut (North Atlantic Këshilli NAC) të lidhura me sfidat globale të sigurisë.



# Gjeneral Dilaver Poçi

## Burrë me trimëri dhe mënçuri të rrallë

Në kuadrin e 100 vjetorit të lindjes së Gjeneralit fushëbardhas Dilaver Poçi



në vendlindje në fshatin Fushëbardhë. Aty ngriti të parin njësit të fshatit dhe vazhdoi të punojë për ngritjen e njësitit gueril të krahinës së Kardhiqit. Për dhjetë muaj rresht luftë e përpjekje Dilaveri i ra krahinës së Kardhiqit dhe Kurveleshit kryq e tërthor, shtëpi më shtëpi, konak më konak e stan më stan. Më 1.4.1942, Dilaveri do të ndiqte nga afër formimin e çetës së parë partizane të Kurveleshit e cila u mblodh në Malin e Gusmarit. Zhvilloi aksione dhe asgjësoi mjaft spiunë të fashizmit, midis të cilëve dhe nënprefektin e Kurveleshit. Goditi karabinierët e xhandarmërisë armike si në Zhurin e Gusmarit, Garxhun, Ujë të Ftohtë të Tepelenës etj. Çeta e Kurveleshit ishte çeta e dytë e krijuar në Shqipëri pas asaj të Pezës. Në tetor 1942, Dilaveri, do të gjendej në Sheper të Zagorisë, atje ku formohej çeta "Koto Hoxhi", me komandant Pano Xhamballa dhe komisar Vasil Kati, të dy miq të Dilaverit.

### Në Fushëbardhë krisma e parë për çlirimin e Shqipërisë

Me përvojë të pasur në aktet sublimë popullore të themelimit të formacioneve të para partizane, do të kurorëzonte në fshatin e tij të lindjes, në Fushëbardhë, më 12 dhjetor 1942, në sheshin e quajtur Zhërmë, te rrapit shekullor, krijimin e çetës së krahinës së Kardhiqit (fillimisht e quajten çeta e "Çakallit" (pseudonimi gjatë LANÇ). Kjo çetë, me vendim të Qarkorit të Gjirokastrës, më 27.2.1943, në fshatin Prongji, do të pagëzonte me emrin "Çerçiz Topulli". Nga ndonjë mosnjohës i luftës së vërtetë të kësaj çete, me apo pa dashje, është ngatërruar data dhe vendi i krijimit të çetës me datën dhe vendin e dhënies së emrit, që në fakt 12.12.1942 dhe vendi Fushëbardhë është i shenjtëruar.

Në pranverë 1943 numëri i çetës u shtua shumë, gati u trefishua me partizanë e partizane nga fshatrat e krahinës së Kardhiqit, por edhe nga qyteti i Gjirokastrës. Çeta "Çerçiz Topulli", e komanduar nga Dilaver Poçi, kreu një veprimtari luftarake të dendur në zonën e Kardhiqit, në Rrëzomë të Delvinës (Janar 1943) dhe në Vurg të Sarandës, ku ka kryer dy inkursione të sukseshme: i pari nga 5 shkurti 1943 deri në 23.2.1943 dhe i dytë nga 2.3.1943 deri 20.3.1943. Çeta dha një ndihmesë në formimin e Këshillave Antifashiste Nacionalçlirimtare në disa fshatra të Kardhiqit, ku ende nuk ishin krijuar ato dhe për plotwsimin e disa të tjerave që kishin pësuar ndryshime. Çeta më 18 deri 20 dhjetor 1942 preu linjat telefonike e telegrafike Delvinë-Sarandë, goditi postbllokun italian te Ura e Shijanit, mbi lumin e Kalasës, në rrugën Delvinë-Sarandë, sulmoi një togë të përforcuar e të fortifikuar, duke i shkakuar dëme në

njerëz dhe humbje të mëdha në materiale. Në mes të muajit janar 1943 çeta goditi me organizim prite një kamion me ushtarë fashistë, në afërsi të urës së Kardhiqit, në rrugën Gjirokastër-Tepelenë dhe një grup milicësh. Efektivitetin e çetës "Çerçiz Topulli" në krahinat e Vurgut e të Theologos, Lefter Talo e pasqyron në raportin që i bën Komitetit Qarkor për Gjirokastrën, raport i cili gjendet në arkivin e rrethit të Sarandës dhe AQSH: "Dilaveri u bë simbol i unitetit të trevave shqiptare e minoritare, lebërve e vurgarëve, bregasve e çamëve. Ishte zona e një uniteti të fortë që krijoi, farkëtoi e siguroi lidhje të qëndrueshme në emër të idealeve të larta të lirisë dhe të pavarësisë, pavarësisht kombësisë".

### Bashkëveprimi çelësi i suksesit në luftën çlirimtare

Bashkëveprimi e bashkërendimi i veprimeve luftarake ishte çelësi i suksesit. Djemtë e Labërisë ndër ta Dilaver Poçi, u bë shtysë e fillimeve të luftës antifashiste në të gjithë Labërinë. Çetat partizane "Çerçiz Topulli", të Kurveleshit, çeta e Rinisë në Stegopol, çeta "Koto Hoxhi" etj., kryen veprimet edhe të përbashkëta dhe hodhën vështrimin për rritjen e lëvizjes antifashiste në qarkun e Gjirokastrës, ku u formuan disa batalione territoriale dhe batalione partizane më të organizuara si "Asim Zeneli", "Misto Mame", "Thanas Ziko" etj. Në qark u krijuan kushtet për krijimin e katër nga njësitë më të mëdha të UNÇSH dhe më konkretisht: Brigada e VI-të Sulmuese, formuar në 26.1.1944 në Përmet, ishte e para brigadë në qarkun e Gjirokastrës, me partizanët e batalioneve "Asim Zeneli", "Baba Abaz", "Abas Shehu", "Naim Frashëri", kompania "Thoma Lulo" e batalionit "Çamëria", ku më vonë u fut dhe batalioni "Zaho Koka". Brigada e VIII-të Sulmuese, u formua në 25.4.1944 në Sheper të Zagorisë. Brigada e XII-të Sulmuese u krijua në Sukë të Përmetit më 20.5.1944 me 600 partizanë të ardhur nga Zona e Parë Operative Vlorë-Gjirokastër. Brigada XIV-të Sulmuese, u formua në 20.8.1944 në fushën e Sheperit, me partizanë të Grupit I partizan të Kurveleshit, të Grupit III partizan të Mallakastrës dhe të Grupit IV partizan të Çamërisë, që bënin pjesë në ZIOp, Vlorë-Gjirokastër. Pas çlirimit të Shqipërisë, Brigada e XIV-të Sulmuese u vendos në Vlorë e Sazan.

### Në formacionet e mëdha partizane të konsoliduara

Në zbatim të urdhërit të Shtabit të Përgjithshëm, më 25 prill 1944, në Sheper të Zagorisë u formua një nga njësitet më të mëdha dhe më në zë të UNÇSH, Brigada e VIII-të Sulmuese. Fillimisht, Dilaveri u

emërua zv/komisar në batalionin e parë të Brigadës së VIII-të Sulmuese Veprimet kryesore luftarake të Brigadës së VIII-të Sulmuese fillojnë në prag të qershorit 1944 deri më 14.2.1945 në Bosnjën Jugore në 383 ditë lufte, nga të cilat 266 ditë në Shqipëri dhe 117 ditë jashtë kufijve. Brigada bëri 3700 km marshim dhe zhvilloi 113 luftime e veprime luftarake të shkallëve taktike si dhe tre operacione taktiko-operative. Dilaver Poçi ishte pjesëmarrës në të gjitha luftimet e brigadës deri më datën 1 nëntor 1944 që kalon zvendëskomisar Brigadës XI-të Sulmuese. Komanda e Përgjithshme urdhroi Brigadën e XI-të Sulmuese të merrte pjesë në luftimet për çlirimin e kryeqytetit, si një nga misionet kryesore për të cilat u krijua. Menjëherë pas çlirimit, më 7.4.1945, Brigada XI-të Sulmuese u vendos në Kukës pasi kishte kryer me sukses operacionet ndaj mbeturinave të fashizmit në zonat Shkodër, Tropojë e Kukës. Brigada e XI-të Sulmuese përshtroi 1100 km rrugëtim luftarak me beteja.

### Nga Kukësi në degën politike të divizionit të Tiranës

Në ditët e para të prillit 1946 urdhëri i transferimit për Kapiten I-rë Dilaver Poçi, kishte mbërritur në Brigadë. Dilaveri do të shkonte në një detyrë në degën politike të divizionit të Tiranës. "Ky është sektori më i përshtatshëm për të, që aktualisht po punon në atë politiko-ushtarak, në pastë nevojë për sektorin politik, por duke punuar pranë një komandanti kompetent", shkrunte atëherë, i ngarkuar me sektorin e personelit, Komisari i Divizionit të Dytë, N/kolonel Arif Hasko.

### Vlerësimi nga Moska, 2000 km larg për Major Poçin

Në tekstin origjinal në Rusisht, të ardhur nga Akademia politiko-ushtarakë në Moskë thuhet se: "Dilaver Poçi ka ardhur dhe ka filluar mësimet në Akademinë ushtarakë politike në prill 1949. Edhe pse gjuhën ruse fillimisht nuk e dinte, në sajë të një pune të madhe gjatë periudhës së kursit përgatitor e përvetësoi në atë shkallë, që të mund të fillonte mësimet bazë të programit të Akademisë. Në mësim ka shfaqur dashuri dhe vendosmëri. Rezultatet në provimet vjetore i dha si i dalluar. Është i disiplinuar dhe mjaft zbatues. Është i shoqëruar dhe ka qenë një zë autoritar dhe i logjikshëm. Ka marrë pjesë aktive në veprimtarinë sportive masive në fakultet. Në jetesë është mjaft korrekt e i përmbytur. Ngjarjet politike të jetesës së brendshme dhe ndërkombëtare, i kupton dhe i shpjegon ato drejtë. Ka qenë i disiplinuar, kërkues ndaj vetes dhe ka cilësi shumë të mira organizuese. Mund të shfrytëzohet si një kuadër i denjë për punë politike".

### Student në Moskë dhe autor i studimeve me vlera

Dilaver Poçi në periudhën prill 1949-prill 1951 pati fatin të studionte në Akademinë politiko-ushtarakë "V. I. Lenin" në Moskë. Pas dy vjetësh, për arsye pune, ndërpreu studimet dhe i rifilloi pas pesë vjetësh, në vitet 1956-1958. Dilaveri ishte përsëri student, tani më i pjekur dhe më kompetent, një autoritet midis studentësh dhe pedagogësh. Ai ishte një kuadër tashmë me eksperiencë nga frontet e luftës dhe të punës, kishte arritur të triumfoje dhe të vihej në udhëheqje të studentëve shqiptarë, falë aftësive, dhuntive dhe horizontit të gjerë të tij veti këto mjaft të spikatura. Dilaver Poçi vinte nga shkolla e luftës, nga përvoja e ngritjes së ushtrisë së re shqiptare si dhe nga fronti i punës dhe e përpjekjeve të

mëdha e sublimë në të cilat ishte përfshirë në atë kohë Shqipëria. Fjala e tij e ngrohtë argumentuese, pa e ngritur zërin e pa u imponuar, e ngadaltë, e matur dhe e saktë edhe si student në akademi do të impononte respekt.

### Diplomati ushtarak Gjeneral Dilaver Poçi 201 ditë betejë diplomatike

Byroja Politike u mblodh me urgjencë atë natë qershori të vitit 1961. Kërkohej një kandidaturë ushtarake e besuar dhe e pjekur nga ana diplomatike dhe e kompletuar ushtarakisht e politikisht, që të përfaqësonte shtetin dhe ushtrinë shqiptare në një ballafaqim të hapur me një superfuqinë e kohës, siç ishte BS. Byroja Politike e KQPPSH nxori vendimin Nr. 0337 datë 26.6.1961. Gjeneral Poçi vinte në këtë detyrë nga funksioni i Drejtorit Politik në MMP, funksion që po e kryente prej tre vjetësh (22 shkurt 1958 deri në 26 qershor 1961).

Paraardhësi i Dilaverit në Moskë në atë kohë kishte qenë Gjeneral Halim Ramohito, i cili ishte shpallur "non grata" nga qeveria sovjetike. Pas daljes së vendimit, familjarisht, me bashkëshorten, Hyrmeten dhe fëmijët, u nisën për në Moskë. Gjeneral Dilaveri qëndroi në detyrë në Moskë për 201 ditë, nga data 26 qershor 1961 deri 12 prill 1962, ku edhe ai u shpall nga rusët person "non grata".

### "Fshesa e hekurt" në Ushtrinë Popullore shqiptare

"Fshesa e hekurt" në ushtri në vitin 1974, ishte një gjëmë e madhe mbi ushtrinë e kohës. U dënuan rreth 400 oficerë. Lidershipi u burgos dhe u denigrua. Kështu Dilaver Poçi, ishte gjenerali që përfundoi në Cërrik dhe u internua në Belsh në kohën kur kryente detyrën e drejtorit të Drejtorisë Politike në MMP. Ai vlerësohej si një nga strategët më të mirë të politikës ushtarake e të mendimit, por që fati nuk e përkëdheli. Dilaver Poçi ishte një gjeneral me përvojë dhe i përgatitur në mënyrë të shkëlqyer në fushën politike, ndërsa atë ushtarakë ua linte komandantëve. A duhej internuar ky ushtarak madhor?! Kështu u veprua edhe me shumë të tjerë. Edhe pas internimit, Dilaver Poçi ka mbajtur qëndrim burrëror, nuk lajthiti, por ndoqi parimet e drejta të demokracisë pa kaluar në ekstreme. Korrekt, njerëzor, i respektueshëm, i dashuruar me librin, nuk merrej me fjalë boshe. Ishte një komisar tipik me karakteristikat më të mira. Ishte koha kur "gjithë populli ushtar", drejtohej nga një korpus prej 16500 oficerësh, por që katërqind të dënuar ishte një goditje e lidërshipt ushtarak.

### Gjeneral Dilaver Poçi 80 vjeçar në vijë të luftës në Kosovë

Më 3 mars 1999 media e shkruar dhe elektronike njoftonte se një grup veteranësh të LANÇ-it, ish-ushtarakë madhorë, të Ushtrisë shqiptare vizituan zonën verilindore të Shqipërisë; ndërkohë që Shqipëria po përkujtonte 55 vjetorin e çlirimit. Ishin emra të mirënjohur si: Dilaver Poçi, Zeqiri Mero, Sadik Bekteshi, Halim Ramohito, Rrahman Parllaku, Muharrem Kokomani, Gjergj Tani, Sejdim Avdiu, Thoma Xhixho, Adnan Qatipi, Qamil Poda, Enver Begeja, Veli Llakaj, Tefik Ruçi, Nikollaq Sallabanda, Kapo Kapaj, Muharrem Mulgeci, Nexhmi Menzelxhiu, Faiko Zaimi. Burra me merak pjesëtarë në "partinë" e kombit shqiptar. Ishte besa për Arbërinë e ngelur jashtë nga padrejtësinë e europianëve më 1913, megjithëse zgjidhjen finale e dha NATO në ajër dhe UÇK në tokë.

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI  
Akademia e Forcave të Armatosura

Gjenerali lab me  
tipare aristokrate

Dilaver Poçi ishte gjeneral fisnik, që pushtoi mendjet e zemrat e njerëzve në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në paqe. Mendonte e vepronte si gjeneral duke bërë jetën e ushtarit, kishte tipare fisnike mëse njerëzore e aristokrate. I shërbeu partisë-shtet dhe u godit nga partia në kulmin e karrierës së tij në moshën 50 vjeçare. Dilaveri u qëndroi konseguent e besnik idealeve të LANÇ-it dhe nuk i shkeli asnjëherë ato, duke qenë dhe zëvendëskryetar i Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Popullit Shqiptar. Ai ishte bir i Fushëbardhës që ngeli deri në fund të jetës pjesë e korpusit ushtarak me gjykim e mendim progresiv të thellë ushtarak. Nga brezat e ushtarakëve kujtohet si oficer i pjekur, diplomat i matur. Ai ishte dhe mbeti djalë vendi e llaf kuvendi sikurse thotë populli "fjala si binte në tokë" sepse kishte zgjuarsi e intuitë të hollë labe.

### Fisi "Poçi" nga Fushëbardha e njerëzve zemërbardhë

Hadër Poçi, i biri i Poço Xhuvanit dhe gjyshi i Dilaverit, lindi në vitin 1842, në Fushëbardhë të krahinës së Kardhiqit. Ai jetoi, punoi dhe luftoi në Fushëbardhë dhe në të gjithë Labërinë. Ndërsa Habili, babai i Dilaverit, gjatë gjithë jetës, përcolli aftësi të spikatura e cilësi të trashëguara si luftëtar, punëtor, shumë i shoqëruar dhe që mbi-jetoi nga shtypja osmane deri në periudhën e pasluftës së Dytë Botërore. Vetëm 6 muaj pasi kishin ikur nga Fushëbardha, Habilit dhe Sherifesi u lindi djali i parë, që e quajten Dilaver, emër që e mbajti denjësisht 82 vjet, emër që e la në kujtesën e brezave. Ai lindi më 25 maj 1919.

Në vitin 1926, babai i Dilaverit, Habili u rikthye në Fushëbardhë. Me vete kishin katër vocërrakë; më i madhi, Dilaveri 7-vjeçar, Zenepja 5-vjeçare, Myzejeni 3-vjeçare e Drita 1 vjeçe. Pas një viti në Fushëbardhë familja shtohet edhe me një djalë: Zenelin. Por pas dy vjet qëndrimi në fshat familja merr sërish rrugën drejt Sarandës, ku kishin shumë miq e shokë. Shkollimi ishte preokupimi kryesor. Dilaveri 9 vjeçar mundi të futej në shkollë në vitin 1928, në Sarandë. Shkolla ishte për të një dritare e madhe diturie, ku jepnin mësim Irfan Roshi, drejtori Hiqmet Roshi, Lame Xhama, Sadik Pejani, Xhevdet Kofina, Muhamet Golemi, Xhemile Golemi etj. Pas përfundimit të shkollës në Sarandë me këmbënguljen e tij takon ish-ministrin e Arsimit të Monarkisë Fran Ivanaj, i cili ndihmonte shumë njerëzit që kishin etje për dituri. Ai i akordon një bursë studimi në Institutin Teknik i Mbretnisë shqiptare/Shkolla e Mesme Teknike "Harry Fultz". Fakt është që, Dilaveri shkëlqeu në mësimet në shkollën e suksesit amerikan në Shqipëri ku mësuës të përkushtuar ishin ndërmjet të tjerëve dhe dy amerikanë, Harry T.Fultz & Charl A.Hollingshed. Edhe sot në këtë shkollë gjenden arkivat e viteve '20-të të shekullit të kaluar ku për nxënësin Dilaver Poçi dedikimi është "excellent"/i shkëlqyer.

### Aktiviteti revolucionar i antifashistit të orëve të para

Veprimtaria revolucionare e Dilaverit gjatë viteve të pashkollës teknike, 1938-1941 erdhi duke u rritur sidomos në Tiranë e Vlorë, por me objeksione më të qarta ajo ka qenë në qytetin e Sarandës. Që nga viti 1938 ka qenë anëtar i grupit komunist të Shkodrës, nga merrte detyrat si aktivist. Ka qenë një ndër 200 anëtarët e parë themelues të PK. Me porosi të Qarkorit të Gjirokastrës ai kishte ngritur njësitin e Sarandës. Por aktiviteti i tij i dendur kishte rënë në sy të fashistëve. Bënte pjesë në rininë elitare të jugut me pikëpamje të fuqishme antifashiste.

Dilaver Poçi kishte rënë në sytë e spiunëve të fashizmit në Sarandë dhe ndërkohë pritej arrestimi i tij. Për t'i shpëtuar ndjekjes më 7 shkurt 1942 u largua nga Saranda dhe kaloi në ilegalitet, duke shkruar



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

## Nga njeri i thjeshtë në hero

Pasuria më e madhe e një kombi është historia e tij, e njerëzve të vet që e bëjnë dhe e krijojnë në vazhdim. 17 maj 1941 na bën të reflektojmë, por dhe të kuptojmë sa themeltare në histori është bashkëkombësi që bën emër duke na u imponuar me modesti, nga shqiptar i thjeshtë dhe me shpirtin e tij, bëhet hero. Vasil Laçi qëlloi me pesë plumba perandorin italian Viktor Emanueli III. Ishte një djalosh rreth 19 vjeçar. Ngjarja e dukshme, tepër e rrallë në biografinë tonë kombëtare, por dhe në Ballkan, ndodhi në kryeqytet, në Rrugën e Durrësit, në Tiranë. Në këtë rrugë është e vështirë të dallosh një basoreliev të vogël, që tregon një histori kombëtare.

Vasil Laçi mund të themi pa frikë se është më i famshëm i Ballkanit në Luftën e Dytë Botërore. Kur i riu Vasil Laç, ngriti dorë dhe qëlloi mbi “mbretin-perandor”, fashizmi ishte shndërruar në fuqi globale dhe tepër të pathyeshme. Hitleri dhe Musolin kishin vënë nën sundim pothuaj gjithë hapësirën e Evropës. Në këtë kohë këto dy fuqi kishin përfunduar dhe pushtimin e të gjithë gadishullit të Ballkanit. Fundi i prillit 1941 kishte përfunduar pushtimi i Jugosllavisë dhe i Greqisë. Britania e Madhe nuk po e zotëronte dot Ballkanin, ndërsa Bashkimi Sovjetik ishte i vetëm në fillimin e kësaj lufte. Dhe ky vend që zotëronte një territor sa një e gjashta e botës, u sulmua pak ditë më pas nga jehona e pesë të shtënave të revolverit të Vasil Laçit. Më 22 qershor 1941, Hitleri nisi sulmin kundër Bashkimit Sovjetik, duke thyer dhe paktin e molotovi të firmosur nga Ribentrop dhe Molotovi me pëlqimin e Hitlerit dhe të Stalinin.

## Rezistenca e madhe kombëtare antifashiste kishte filluar

Kur i riu shqiptar, patrioti Vasil Laçi kreu aktin e rrallë guximtar, komunistët në vend ishin një pakicë numerike. Ata nuk kishin ndonjë ndikim në popull, si në planin ideologjik, politik, por dhe në aksione konkrete kundër pushtuesit fashist. Ndoshta kjo dhe për shkak të detyrimit që të respektonin traktatin Ribentrop-Molotov për bashkëpunim mes Gjermanisë dhe Bashkimit Sovjetik, duke qëndruar të tërhequr, por rezistenca e madhe kombëtare antifashiste kishte filluar.

Me heroizmin e tij si shqiptar dhe patriot Vasil Laçi atë ditë provoni rezistencë popullore, shpërthimin e urrejtjes kundër fashizmit dhe pushtuesit italian. Kjo rezistencë kishte nisur që në Romë, më 13 maj 1939, kur rreth katërqind studentë shqiptarë që studionin në shkollat dhe akademitë ushtarake italiane, kishin refuzuar betimin ushtarak Italian. Të mbledhur me detyrim ata e refuzuan publikisht dhe para ushtarakëve të lartë fashist. Nisi kundër tyre një represion dhe gjyqe të heshtura, deri në burgime dhe në eliminim të studentëve, si Shahi Toçi etj. Por për të vënë në vend nderin e humbur prej studentëve shqiptar, bashkëkombas “me emër”, pak ditë më parë, më 16 prill 1939, udhëtuan

# 2 maj 1941: Plumba mbi Perandorin dhe varje në litar



drejt Romës dhe i dhuruan “Mbretin-Perandor” Viktor Emanueli III kurorën e artë të Skënderbeut. Studentëve ushtarakë shqiptarë ky veprim ju kushtoi 16 të burgosur dhe të internuar në ishullin Ventotene, si dhe një të eliminuar në fshehtësi të madhe.

## Plumbat e Vasil Laçit flisnin për Shqipërinë

Deri në momentin kur i riu Vasil Laçi shtiu me plumb mbi perandorin, nga pushtuesit italianë ishin bërë bastisje banesash, si dhe kontrolle të personave, ku në kampet e përqëndrimit të Italisë numëroheshin rreth 5279 patriotë shqiptarë.

Akti i të riut shqiptar që qëlloi mbi perandorin ishte i jashtëzakonshëm dhe me rëndësi si për Shqipërinë, për Ballkanin, por dhe për historinë e Luftës së Dytë Botërore. Ky akt deri diku në atë kohë ngeli në harresë. Tërë Ballkani ishte nën pushtim dhe për aktin heroik të të riut shqiptar që ishte sinjal për rezistencë nuk u shkrua asnjë rresht për çfarë ndodhi në mes të kryeqytetit shqiptar. Greqia ishte nën pushtim. Edhe në Itali, çensura ishte në kulm, si dhe në Tiranë. Heshtja e pushtuesve fashistë ishte pasojë e asaj që prej 7 prillit 1939, fashistët italianë shqiptarët i kishin paraqitur në opinionin botëror se ishin pritur me tufa me lule. Plumbat e Vasil Laçit flisnin për të kundërtën në Shqipëri.

Vasil Laçi e torturuan egërsisht për dhjetë ditë me radhë. Në këto ditë fashistët nuk i kursyen të gjitha llojet e shpifjeve, i vendosën emër tjetër dhe origjinën ja bënë greko-maqedonase. Madhështia e vërtetë e aktit dhe e gjestit të tij, flet shumë para gjithë botës së qytetëruar dhe demokratike. Vasil Laçi si patriot shqiptar u përpoq të shtinte mbi mbretin e Italisë dhe uzurpatorin e fronit të Shqipërisë, Viktor Emanueli III, si dhe Shefqet Bej Vërlacin, Kryeministër i Shqipërisë, pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Vasili kishte lindur në fshatin Piqeras në Shqipërinë jugore afër qytetit të Sarandës në vitin 1922. Fëmijërinë e tij e kaloi në Piqeras, ku dhe studio në shkollë fillore. Në 1939 gjendet në Tiranë, për t'u punësuar për bukën

e gojës.

## E përcolli me plumb perandorin

Viktor Emanueli III kishte planifikuar një vizitë në Shqipëri dhe pasi mori garanci nga policia fashiste italiane në Tiranë, nisi vizitën. Vasili e merr vesh për vizitën e Viktor Emanuelit në Shqipëri që më 2 maj 1941. Ai mori hua një pistoletë Beretta nga Pëllumb Koka, një tjetër patriot shqiptar, ku dhe ishte strehuar e punësuar. 19-vjeçari Vasil Laçi,


këmbësorisë, të kalorësisë, të formacioneve fashiste të ndarë më tre kolona në të dyja anët e rrugëve, ndërsa sipër fluturonin skuadriljet e aeroplanëve. Në këtë atmosferë pasigurie e frike, rrethuar kudo me helmata dhe armë, i riu patriot Vasil Laçi, hyri në mes të turmës dhe priti rastin e volitshëm. Ai ngriti dorën mbi helmata dhe grykët e armëve fashiste dhe qëlloi pesë herë në drejtim të Perandorit.

Populli shqiptar me dorën e njërit prej bijve të tij, e përcolli me plumb

III shpëtoi pa u vrarë, vetëm në saj të agjentëve të policisë së fshehtë italiane që atë ditë ndodheshin në gatishtëri të lartë dhe ia kapën menjëherë revolverin djaloshit, por plumbat e pistoletës së tij fshikulluan lehtë Kryeministrin shqiptar Shefqet Vërlaci, që ndodhej në makinë me Mbretin e Italisë. Ai realizoi pesë të shtëna në drejtim të tyre, por pa mundur të vrasë perandorin. Laçi u arrestua menjëherë. Qeveria fashiste italiane sulmin e tij e trajtoi për çështje ekonomike dhe se ai kishte me Shefqet Bej Vërlacin.

## Vend nderi në altarin e lirisë si patriot

Regjimit komunist atentatin e djaloshit Vasil Laçi ndaj Mbretit të Italisë, Viktor Emanueli III, nuk e përvetësoi dhe nuk e paraqiti si vepër të komunistëve, por ai zuri vend nderi në altarin e lirisë si patriot dhe atdhetar i lavdishëm. Në librin Yje të Pashuar, për këtë ngjarje, thuhet fjalët e Vasil Laçit se “E bëra vetë, për Shqipërinë / Rroftë Shqipëria e Lirë / Poshtë fashizmi”. Atentati i djaloshit shqiptar, që qëlloi Viktor Emanuelin III në rrugën e Durrësit, ishte fillimi i një kryengritjeje të madhe që po përgatitej. Plot 78 vjet më parë, më 27 maj të vitit 1941, do të varej në litar sepse guxoi dhe shtiu pesë herë me plumba mbi Mbretin e Italisë dhe Perandorin e Etiopisë, Viktor Emanueli III, të pagëzuar edhe si Mbret i Shqipërisë pas dorëzimit të Kurorës së Skënderbeut. Për veprën patriotike dhe



ditën e largimit të perandorit, u vesh me një kostum kombëtar shqiptar dhe qëlloi mbi makinën ku ishte Viktor Emanueli III dhe Shefqet Bej Vërlacin, Kryeministër i Shqipërisë. Pritej nga çasti në çast të kalonte Perandori. Filloi kortezhi i veturave. Sovrani, në një veturë të hapur, kalonte përmes batalioneve të

Perandorin Viktor Emanuelin III. Perandori kishte mbaruar vizitën e tij shtatëditore në Shqipëri dhe po largohej në drejtim të aeroportit të Laprakës, në Rrugën e Durrësit, u qëllua nga djaloshi 19-vjeçar, me origjinë nga fshati Piqeras i Sarandës, i cili quhej Vasil Laçi. Ndërsa Mbreti Viktor Emanueli

antifashiste këtij luftëtari dhe atdhetar i është kushtuar: një monument në Tiranë për të nderuar aktin e tij heroik, një libër, një film “Plumba mbi Perandorin”, vendosje të emrit të tij në rrugë dhe shkolla të vendit, e shpalli Dëshmor të Atdheut, si dhe e vlerësoi me titullin e lartë “Hero i Popullit”.



**M**e pjesëmarrjen e gjimnazistëve të shkollave të mesme, në zonën e Vaut të Dejës, më 23 maj, u zhvillua "Dita e Hapur", në Batalionin e Parë të Këmbërorisë të Forcës Tokësore (b1kFT).

Zëvendësministri i Mbrojtjes z.Petro Koçi, duke përshëndetur gjimnazistët, ndër të tjera u shpreh: "Ne duam që në Forcat e Armatosura të kemi djem dhe vajza, që janë të zotë, që janë të aftë, që përballojnë testimet intelektuale, psikologjike dhe fizike, por ajo që është kryesorja është, që ata të jenë patriotë të vërtetë". Kurse komandanti i Batalionit të Parë të Këmbërorisë, nënkolonel Ali Mali, shprehu kënaqësinë e tij për praninë e të rinjve të shumtë, që kishin mbushur repartin këtë ditë. Ai u bëri thirrje të rinjve të bashkohen me radhët e Forcave të Armatosura, duke i garantuar ata se do të ndihen krenarë për punën që do të bejnë dhe për edukimin që do të marrin. Të njëjtën ftesë për të rinjtë përsëriti edhe komandanti i QPR kolonel Isuf Hamati. Më pas, të pranishmit vizituan standat me armatimin dhe pajisjet në përdorim nga efektivi i Batalionit I të Këmbërorisë të Forcës Tokësore.

Vau i Dejës-Dita e hapur në Batalionin e Parë të Këmbërorisë

## "Rini-Mundësi-Talent-Dinjtet"

